



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe nenin 14, ndërlidhur me nenin 17 shkronjat b) c) dhe e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 14, 15 paragrafi 2.4, nenit 17 ndërlidhur me nenin 19 paragrafët 1.2; 1.3; 1.5 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, pas shqyrtimit të Raportit të datës 05.04.2024 të Komisionit ad-hoc i ngritur me Vendimin nr.prot.02-020/04-0021249/24 datë 02.04.2024, proceduar në Kuvend nga Ekzekutivi i Komunës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2024, merr këtë;

V E N D I M PËR RRËNIMIN E OBJEKTIT ISH - SHTËPI E KULTURËS

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës miraton rekomandimin për rrënimin e objektit ish-Shtëpi e Kulturës, sipas Raportit të datës 05.04.2024 të komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën rreth viteve 1982-1985 me destinim për “Shtëpi të Kulturës” i cili gjendet në udhëkryqin që lidhë rrugët “19 Qershori” dhe “Zahir Pajaziti”, në qytetin e Podujevës.

Neni 2

Kuvendi i Komunës autorizon Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe Drejtoritë tjera relevante të Komunës së Podujevës, që të ndërmarrin gjitha masat dhe veprimet e nevojshme në funksion të zbatimit të këtij vendimi.

Neni 3

Këtij vendimi i bashkëngjitet Raporti i datës 05.04.2024 i komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën rreth viteve 1982-1985 me destinim për “Shtëpi të Kulturës” i cili gjendet në udhëkryqin që lidhë rrugët “19 Qershori” dhe “Zahir Pajaziti” në qytetin e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-354/03-0033732/24
Podujevë, datë, 23 maj 2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva



RAPORTI I KOMISIONIT

Komisioni i formuar ad-hoc për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën rreth viteve 1982-1985 me destinim për "shtëpi kulture" i cili gjendet në udhëkryqin që lidhë rrugët "19 Qershori" dhe "Zahir Pajaziti", në këtë përbërje:

Ismet Kadriu , inxh i dipl i ndërtimtarisë (Drejtorja e Urbanizmit)
Veton Aliu , inxh i dipl. i arkitekturës (Drejtorja e Urbanizmit)
Kujtim Zhitia , zyrtar (Drejtorja e Shërbimeve Publike)
Isak Uka , zyrtar (Drejtorja e Pronës dhe Katastrit)
Afrim Mulliqi , zyrtar (Drejtorja e Shërbimeve Publike)

Komisioni në përbërje të plotë filloi punën e vet me datën 04.04.2024 me vizitën në objektin e lartëcekur duke vizituar të gjitha hapësirat e objektit dhe konstatoj :

Se gjendja faktike e objektit është e rëndë duket si një gërmadhë , si një deponi mbeturinash , strehë për zogjët që mund të jetë edhe burim i infeksioneve të ndryshme . Pra , me një pamje të shëmtuar si pasojë e 40 viteve të kaluara .

Vërehet qartë se objekti në fjalë nuk ka qenë i përfunduar asnjëherë .
Që nga vitet 80-ta të ndërtimit objekti ka mbetë i pa përdorshëm dhe i pa përfunduar për shkak të gabimeve në projektim dhe ndërtim.

Si faktor kryesor i mos përfundimit dhe mos përdorimit ka qenë mbushja e bodrumit me ujë nëntokësor deri në përdhesë dhe depërtimi i lagështisë nga themelet , në muret e betonit , shtyllat dhe elementet tjera konstruktive.

Për nga ana statike vërehen dëmtime të shumta në pllakat dhe muret e objektit , armatura e ndryshkur , shtyllat dhe trajet e dëmtuara si pasojë e ujërave nëntokësore , pastaj nga reshjet atmosferike si dhe faktori kohë .

Edhe nga vështrimi arkitektonik duket si një arkitekturë e tejkaluar (mendim i komisionit) .
Materializimi i saj me elemente moderne do të kishte një kosto shumë të madhe . Në këtë gjendje edhe inkorporimi i këtyre elementeve mundet të mos ketë stabilitet në strukturën e objektit .

Lagështia e objektit e akumuluar ndër vite ka bërë që ky objekt ta humbë edhe stabilitetin e strukturës . Duket se objekti , përkatësisht pllaka e themeleve nuk ka farë hidroizollim , prandaj sanimi , ose izolimi i tij është i pamundur.

PËRFUNDIM:

Komisioni rekomandon se objekti nuk mund të renovohet , rehabilitohet ose të funksionalizohet si objekt për *Shtëpi të Kulturës* .

Përfundimisht ne si komision rekomandojmë që objekti në fjalë të rrënohet tërësisht , ose të mbetet një objekt gërmadhë jo funksional .

Këij raporti i bashkangjiten edhe fotot e bëra gjatë vizitës dhe vlerësimit të objektit .

Dt. 05.04.2024
Podujevë

K o m i s i o n i ,

1. Ismet Kadriu , IDN

2. Veton Aliu , IDA

3. Kujtim Zhitia , zyrtar

4. Isak Uka , zyrtar

5. Afrim Mulliqi , zyrtar